

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.20.03.2021*

**20.03.2021  
Ora 19:00**

**RENDI I DITËS**


**"Procedura e shortit për kërkesën ankimore nr.6, subjekti ankues Aleanca-AI"**

**PJESËMARRJA :**

- **KAS:** Z.Elvin LAKO, Z.Elvis ÇEFA, Z.Ilirjan RUSMALI  
(Nuk është prezent), Z.Koli BELE, Z.Ledio BRAHO
- **Stafi KQZ:** Y.Merkaj, O.Peto
- **Parti Politike:**

**Z. Y. Merkaj:** Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve është depozituar një ankim në datën 20.03.2021, me subjekt refuzimin e vendimit "Për miratimin e listave shumemërore të Koalicionit Aleanca-AI". Sipas nenit 14 të Rregullores së Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve do të zhvillohet shorti, për përcaktimin e relatorit për kërkesën ankimore nr.6. Administrata e KQZ-së ka përgatitur 5 shirita letre. Ku në një shirit letre është vendosur numri i ankimit nr.6 dhe katër shiritat e tjerë janë të bardhë dhe pa shënime. Këto shirita do të futen në 5 gogla të cilat kanë ngjyrë, formë dhe peshë të njëjtë në një enë transparente dhe një përfaqësues i administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve do t'i përziejë. Sipas rendit alfabetik rritës, anëtarët e KAS-it do të tërheqin nga ena transparente nga një gogël. Anëtari i KAS-it që do të tërheqë goglën që ka shiritin me numrin e ankimit do të jetë relatori i çështjes. Atëherë, vazhdojmë me procedurën e shortit. Olsi po prezanton shiritat po i palos dhe po i vendos në goglën përkatëse, duke qenë se kemi vetëm një kërkesë ankimore vetëm njëri shirit është me shënimin Kërkesa Ankimore

**Zbardhi materialin audio  
Jona DERVISHI**



**Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.20.03.2021**

nr.4, katër shirita janë të bardhë dhe pa shënim. Përzihen goglat tek ena transparente, sipas rendit alfabetik fillon tërheqja së pari nga zoti Elvin Lako.

**Z. E. Lako:** Tërheq goglën - shiriti del i bardhë dhe pa shënime.

**Z. E. Çefa:** Tërheq goglën - në shirit është Kërkesa Ankimore nr.6.

**Z. Y.Merkaj:** Për llogari të zotit Ilirjan Rusmali tërheq goglën një përfaqësues i administratës së KQZ - shiriti del i bardhë dhe pa shënime.

**Z. K. Bele:** Tërheq goglën - shiriti del i bardhë dhe pa shënime.

**Z. L. Braho:** Tërheq goglën - shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

**Z. Y. Merkaj:** Në përfundim të procedurës së shortit për kërkesën ankimore nr.6, relatori i çështjes është zoti Elvis Çefa.

**Z.E. Çefa:** Seanca paraprake do të zhvillohet në datën 23.03.2021, ora 12:30.

**Zbardhi materialin audio  
Jona DERVISHI**

